

SITUATA ME TË DREJTAT E NJERIUT – RAPORT MUJOR

MUAJIN JANAR

20
25

SITUATA ME TË DREJTAT E NJERIUT – RAPORT MUJOR

Kjo botim u financua nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Shkup dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT

PËRMBAJTJA

01

Hyrje

02

Gjuha e urrejtjes

03

Veprat nga urrejtja

04

**Dhuna në bazë
gjinore dhe dhuna në
familje**

05

Institucione të mbyllura

06

**Ndihmë juridike
falas**

HYRJE

Disa ngjarje në fushën e të drejtave të njeriut shënuan janarin e vitit 2025: Platforma e Organizatave të Shoqërisë Civile për Luftën kundër Korrupsionit reagoi ashpër ndaj përpjekjeve të deputetit Bojan Stojanoski për ta lidhur këtë platformë me ndikimet partiake. Me argumente serioze kundër ndryshimeve të Ligjit për Prokurim Publik, të përkrahura nga KSHPK-ja dhe BE-ja, Platforma kërkoi nga Kuvendi që ta dënojë sjelljen e deputetit Stojanoski.

Mosndëshkimi, i pranishëm për dekada të tëra, ka çuar edhe një herë në tragjedi - Në janar të vitit 2025 humbi jetën 22-vjeçarja Frosina Kulakova. Autori, i cili ka pasur disa vepra të rënda penale, ka vazhduar të marrë pjesë në trafik pa patentë shofer, gjë që tregon për mangësi të rënda nga ana e institucioneve.

Qytetarët ballafaqohen me pasiguri juridike dhe mosbesim në sistem. Shteti duhet të marrë masa të menjëhershme kundër korrupsionit dhe të sigurojë drejtësi dhe siguri.

SITUATA ME TË DREJTAT E NJERIUT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR – JANAR 2025


Gjatë muajit janar, në ueb platformën www.govornaomraza.mk janë regjistruar gjithsej 69 raste me elemente të gjuhës së urrejtjes, thirrje dhe nxitje për diskriminim dhe ngacmim mbi baza të ndryshme.

Këtë muaj janë regjistruar 44 raste (53 %) të gjuhës së urrejtjes për shkak të kombësisë, 20 raste (24 %) në bazë të përkatësisë etnike, 11 raste (13 %) në bazë të përkatësisë politike dhe 5 raste (6 %) në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Në muajin janar vazhdon trendi i rritjes së numrit të aplikimeve të regjistruara në bazë të përkatësisë kombëtare dhe etnike mes dy bashkësive etnike më të mëdha në vend. Edhe një herë në rrjetet sociale janë regjistruar postime të hartave me pretendime territoriale në territorin e Ballkanit Perëndimor.

Përveç kësaj, përkujtimi i përvjetorit të vdekjes së Mara Bunevës shkaktoi komente negative dhe gjuhë të urrejtjes për shkak të kombësisë, e cila u pasua me provokime të ndryshme që konsiderohen kontroverse për sa i përket marrëdhënieve maqedono-bullgare.

PARAQITJA GRAFIKE E SITUATËS ME GJUHËN E URREJTJES NË JANAR 2025



- Gjuhë urrejtjeje e bazuar në kombësi (44)
- Gjuhë urrejtjeje e bazuar në etni (20)
- Gjuhë urrejtjeje e bazuar në përkatësi politike (11)
- Gjuhë urrejtjeje e bazuar në orientim seksual dhe identitet gjinor (5)
- Gjuhë urrejtjeje e bazuar në racë/ngjyrë lëkure (1)
- Gjuhë urrejtjeje e bazuar në fe dhe besim fetar (1)
- Gjuhë urrejtjeje e bazuar në prapavijë sociale (1)

*Platforma regjistroi 69 raste origjinale të gjuhës së urrejtjes - në disa raste, u regjistruan më shumë se një karakteristikë mbrojtëse.

SITUATA ME TË DREJTAT E NJERIUT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR – JANAR 2025

PËRFUNDIME REKOMANDIM

Përfundime:

Gjuha e urrejtjes dhe gjuha ngacmuese në bazë të kombësisë dhe përkatësisë etnike janë në krye të tabelës së rasteve të regjistruara.

Rekomandim:

Krijimi i politikave shtetërore për promovimin e bashkëjetesës dhe integritit të bashkësive etnike dhe kombëtare në Maqedoninë e Veriut.

SITUATA ME VEPRAT NGA URREJTJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - JANAR 2025

Gjatë janarit të vitit 2025, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka regjistruar 7 incidente të mundshme me motive të njëanshme, shumica e të cilave, në përputhje me treguesit e tjerë (vendndodhja, mënyra e kryerjes, përfshirja e të miturve dhe nxënësve të shkollave të mesme etj.), ekziston bindja e arsyeshme se janë kryer për shkak të përkatësisë etnike të viktimës, gjegjësisht autorit. Gjegjësisht, bëhet fjalë për 6 incidente të mundshme në bazë të përkatësisë etnike dhe një incident me bazë gjinore. Sipas llojit të dhunës, incidentet përmbajnë dhunë dhe shkaktim të lëndimeve trupore dhe lëndime të rënda trupore. Në tre prej rasteve, viktimat ose autorët paraqiten persona të mitur.

Incidentet e mundshme janë përfshirë në raport sepse ato lidhen me situata ku tregues të tjerë sugjerojnë se ka arsye për të besuar se këto incidente janë të motivuara nga njëanshmëria. Ndër këta tregues të njëanshëm janë: perceptimi i viktimës/dëshmitarit; komentimi në vendin e ngjarjes; dallimi ndërmjet viktimës dhe dhunuesit në bazë etnike; modeli/frekuenca e incidenteve të mëparshme; natyra e dhunës; mungesa e motiveve të tjera; si dhe vendi dhe koha.

Thënë më saktë, incidentet e mundshme janë përfshirë në këtë raport për shkak të informacionit të marrë në lidhje me vendndodhjen (shembull: lagje ose shkolla etnikisht e përzier, linjat e autobusëve të përdorura nga anëtarë të komuniteteve të ndryshme etnike, vendet ku në të kaluarën kanë ndodhur vepra penale të urrejtjes), llojin (shembull: një grup më i madh në numër i personave të mitur që sulmojnë një ose më shumë viktima pa ndonjë provokim, përleshje grupore, sulme të mëparshme në autobus apo stacion autobusi), koha (shembull: pas përplasjeve të mparshme si formë hakmarrjeje, pas lëshimit nga shkolla, gjatë ose pas një ndeshjeje sportive), dhe prona e dëmtuar gjatë kohës së incidentit (shembull: vendet e ceremonive fetare).

SITUATA ME VEPRAT NGA URREJTJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - JANAR 2025

PËRFUNDIME REKOMANDIM

Përfundime:

Në janar të vitit 2025 janë regjistruar 7 incidente të mundshme me motive të njëanshme, prej të cilave 6 kanë qenë të motivuara etnikisht dhe 1 me bazë gjinore. Në pothuajse gjysmën e incidenteve përfshihen persona të mitur, ndërsa dhuna ndodh në vende publike.

Rekomandime:

Përmirësimi i identifikimit të motivit të njëanshmërisë në incidentet e urrejtjes.

Parandalimi dhe edukimi për të reduktuar rastet e dhunës, veçanërisht tek të rinjtë.

SITUATA ME DHUNËN ME BAZË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - JANAR 2025

Në janar të vitit 2025 është kontaktuar Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në lidhje me një rast lidhur me një vendim të Qendrës për Punë Sociale, me të cilin është rritur ndjeshëm numri i vizitave të një fëmije të mitur me prindin me të cilin nuk jeton. Edhe pse fillimisht fëmija i është besuar njërit prej prindërve për kujdestari dhe edukim, zgjidhja e re praktikisht vendos një model të alternimit të kujdestarisë, ku fëmija do të kalonte një javë me njërin prind dhe më pas një javë me prindin tjetër.

Ky vendim ngre pyetje nëse procedura ka vlerësuar në mënyrë adekuate se sa ndryshimet e shpeshta në mjedis do të ndikojnë në stabilitetin dhe zhvillimin emocional të fëmijës. Për fëmijët në moshë shumë të re, stabiliteti dhe vazhdimësia e zakoneve (shprehive) dhe marrëdhënieve të përditshme janë vendimtare për zhvillimin e tyre të shëndetshëm. Prandaj, vendime të tilla duhet të merren në bazë të një vlerësimi të detajuar nga ekspertët, të cilët do të kenë parasysh jo vetëm të drejtën e prindërve për kontakt, por edhe nevojën e fëmijës për siguri dhe parashikueshmëri në jetën e përditshme. Për më tepër, është e rëndësishme të sigurohet që të merren në konsideratë të gjithë faktorët përkatës në proces, duke përfshirë pasojat e mundshme psikologjike dhe emocionale nga ndryshimet e shpeshta të mjedisit.

Vendimet për kujdesin prindëror duhet të jenë rezultat i një analize të individualizuar të çdo rasti specifik, me fokus parësor në atë që është më e mira për fëmijën, e jo në shpërndarjen e barabartë të kohës midis prindërve si një zgjidhje universale. Vendimi është ankimuar në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar gjithsej 15 raste të ndihmës parajuridike lidhur me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, problemet ligjore dhe prishjet e marrëdhënieve familjare, të ofruara nga personat kompetentë për ndihmë parajuridike të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në shtatë rajonet e vendit. Disa gra kanë qenë viktimat të dhunës fizike dhe psikologjike nga partnerët e tyre, disa prej tyre kanë mbetur pa burime dhe mbështetje financiare, të detyruara të kërkojnë ndihmë ligjore/juridike dhe sociale. Në një rast, një viktimë e dhunës iu nënshtrua presionit të ish-bashkëshortit dhe partneres së tij, të cilët ishin përpjekur ta largonin apo të hiqte dorë nga procedimet ligjore. Ka pasur edhe situata ku gratë kanë kërkuar divorc për shkak të dhunës apo presionit familjar, si dhe raste kur njëri prind ka refuzuar të japë pëlqimin që një fëmijë i mitur të udhëtojë.

SITUATA ME DHUNËN ME BAZË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - JANAR 2025

PËRFUNDIME REKOMANDIM

Përfundime:

Vendimet për kujdesin prindëror duhet të bazohen në një vlerësim profesional gjithëpërfshirës, i cili do të marrë parasysh stabilitetin dhe zhvillimin emocional të fëmijës, dhe jo vetëm të drejtën e prindërve për të mbajtur kontakte.

Rastet e dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore demonstrojnë nevojën për më shumë mbështetje ligjore dhe sociale për viktimat, veçanërisht në drejtim të pavarësisë së tyre financiare dhe mbrojtjes nga kërcënimet dhe presionet.

Rekomandime:

Qendrat për punë sociale duhet të zbatojnë një qasje të individualizuar kur marrin vendime për kujdesin prindëror, bazuar në vlerësimet e ekspertëve për mirëqenien dhe interesat më të mira të fëmijës.

Është e nevojshme të përmirësohen mekanizmat për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, duke përfshirë përmirësimin e qasjes në ndihmë juridike falas dhe mbështetje për fuqizimin ekonomik.

SITUATA ME INSTITUCIONET E MBYLLURA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORTI MUJOR - JANAR 2025

Pasqyrë e përgjithshme e aktiviteteve:

Gjatë muajit janar 2025, Komiteti i Helsinkit ka ofruar ndihmë juridike falas për personat e dënuar në katër raste.

- Dy raste: Lirim me kusht me mbikqyrje mbrojtëse.**
- Një rast: Kujdes shëndetësor për shkak të ofrimit të pamjaftueshëm të kujdesit mjekësor në institucionin e vuajtjes së dënimit.**
- Një rast: Parashtrimi i një kërkesë autoriteteve shtetërore për të krijuar një mjedis që do të minimizojë rreziqet dhe do të mbështesë risocializimin e personave të dënuar.**

Pasqyrë e shkurtër e shërbimeve juridike të ofruara

- Takime të zhvilluara me klientët dhe familjet e tyre për çështje specifike juridike të personave të dënuar.**
- Një vështrim i përgjithshëm i legjislacionit dhe këshillave ligjore të dhëna për lirin me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse.**
- Parashtrimi i kërkesave për qasje të lirë në informacion tek institucionet kompetente.**
- Sigurimi i informacioneve dhe këshillave juridike për klientët.**
- Këshilla të ofruara juridike për risocializimin dhe minimizimin e faktorëve të rrezikut për personat e dënuar.**

SITUATA ME INSTITUCIONET E MBYLLURA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORTI MUJOR - JANAR 2025

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM

Përfundime dhe rekomandime:

Inkurajimi i zbatimit më të madh të masës së lirimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse nëpërmjet bashkëpunimit të zgjeruar ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe shërbimit të probacionit.

Sigurimi i personelit të mjaftueshëm mjekësor, qasja në kujdesin e duhur shëndetësor dhe qasja në ilaçe dhe terapi adekuate.

Zhvillimi i procesit të risocializimit të personave të dënuar, me fokus të veçantë në mbështetjen dhe reduktimin e faktorëve të rrezikut.

NDIHMË JURIDIKE FALAS, RAPORT MUJOR - JANAR 2025 TË DHËNA STATISTIKORE

NJF	28	
NJD	1	
Gjithsej	29	
	Numri	Përqindja
Gjinia		
Meshkuj	16	55
Femra	13	45
Përkatësia etnike		
Maqedonë	23	79
Shqiptarë	4	14
Romë	2	7
Turq	/	/
Serb	/	/
Rajone gjeografike		
Shkup	18	62,5
Vardar	/	/
Pollog	2	7
Pellagoni	3	10
Jugperëndim	2	7
Verilindje	1	3,5
Lindje	3	10
Juglindje	/	/

NDIHMË JURIDIKE FALAS, RAPORT MUJOR – JANAR 2025 TË DHËNA STATISTIKORE

Fusha juridike	Numri	Përqindja
E drejta pronësore	6	20,5
Mbrojtja dhe sigurimi social	2	7
Mbrojtja e fëmijëve	/	/
Sigurimi pensional dhe invalidor	/	/
Mbrojtja dhe sigurimi shëndetësor	1	3,5
Marrëdhëniet e punës	4	14
Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje	5	17
Çështje statusore	1	3,5
Mbrojtja e të drejtave të njeriut	7	24
Të tjera	3	10,5

RAST STUDIMI - NGEÇJE E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka dorëzuar dy kërkesa në Ministrinë e Drejtësisë për miratimin e ndihmës juridike dytësore për një çështje juridike nga sfera e së drejtës pronësore për dy paraqitës të kërkesave, një burrë dhe një grua nga Shkupi. Aplikimi i parë për miratimin e ndihmës juridike dytësore (NJD) është dorëzuar në gjysmën e parë të korrikut të vitit 2024, ndërsa aplikimi i dytë është dorëzuar në gjysmën e parë të janarit të vitit 2025. Këto dy kërkesa janë ende pa epilog, pra pa një vendim përfundimtar nëse kërkesat janë miratuar apo refuzuar, dhe për këtë arsye parashtruesit kanë mbetur pa mbrojtjen e parashikuar gjyqësore të të drejtave të tyre të njeriut, edhe pse i përmbushin plotësisht kushtet materiale dhe financiare për miratimin e NJD-së në përputhje me Ligjin për Ndhmën Juridike Falas.

Konkretisht, zvarritja apo ngecja e procedurës për miratimin e NJD-së në rastin e parë është për faktin se Departamenti për NJF në Ministrinë e Drejtësisë po përballet me një sfidë serioze sa i përket resurseve njerëzore. Situata në nivel të Qytetit të Shkupit është veçanërisht shqetësuese për shkak të mungesës së kuadrit në njësitë rajonale dhe për faktin se aktualisht ka vetëm një zyrtar të autorizuar për të vendosur në lidhje me kërkesat. Pikërisht për këtë, Komiteti i Helsinkit i është drejtuar me urgjencë Ministrisë së Drejtësisë për veprim, duke marrë në konsideratë se nga kërkesa e dorëzuar për miratim të ndihmës juridike dytësore kanë kaluar më shumë se 8 muaj dhe më shumë se 3 muaj nga parashtrimi i Kundërshtimit pas Vendimit për refuzimin e Kërkesës.

RAST STUDIUM - NGECJE E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Sa i përket rastit të dytë, zvarritja e procedurës për miratimin e NJD-së ka ardhur si pasojë e problemit me të cilin ballafaqohet Ministria e Drejtësisë në sigurimin e dokumentacionit sipas detyrës zyrtare nga Agjencia e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme. Përkatësisht, Agjencia e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme për një periudhë të gjatë kohore nuk ka dorëzuar të dhëna për pasurinë e paluajtshme të aplikantëve dhe në përputhje me dispozitat ligjore është e obliguar që ato të dhëna t'i dorëzojë me kohë në njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë. Por, prej kohësh Agjencia ka kërkuar që kërkesat të dorëzohen në mënyrë elektronike (nëpërmjet aplikacionit “e-kat sportel”), por Ministria e Drejtësisë as teknikisht nuk e ka mundur këtë mjet, madje as punonjësit në njësitë rajonale nuk janë trajnuar për dorëzimin dhe marrjen e dokumenteve në mënyrë elektronike.

Gjatë gjithë kësaj kohe, aplikantët janë lënë në mëshirë të veprimeve të Departamentit të Ndihmës Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë, i cili prej kohësh po përballët me mangësi kuadrosh dhe mangësi teknike, situatë kjo e konstatuar vazhdimisht nga shoqatat dhe klinikat juridike në mbledhjet e përbashkëta të mbajtura të Trupit Koordinues Kombëtar, por deri më tani nuk është bërë asgjë për të kapërcyer problemet kronike të sistemit për ndihmë juridike falas.

RAST STUDIUM - NGECJE E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIM

Përfundim:

Mosgjidhja afatgjatë e kërkesave për miratimin e ndihmës juridike dytësore (NJD) për dy aplikantët nga Shkupi tregon për probleme sistematike në funksionimin e mekanizmit të ndihmës juridike falas.

Rekomandime:

Rritja e burimeve njerëzore - Ministria e Drejtësisë duhet të angazhojë kuadro shtesë në zyrat e njësive rajonale në Shkup, për të përshpejtuar shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike falas.